



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**  
**SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR**

Maliq, më 22.01.2024

**Projekt-Vendim**

Nr. \_\_\_\_\_ Date. \_\_\_\_\_

**PËR**

**MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR MBI PROGRAMIN E BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND , PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 1, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë, vendimit nr. 597, datë 22.07.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, pikës 4, të udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për përfitimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, të ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Maliq:

- 1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind, si më poshtë:**
  - Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet regjistrit elektronik për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
  - Do të përzgjidhen ata aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
  - Prioritet do të kenë familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar: familje me shumë anëtarë, familje me 1 anëtar dhe gratë kryefamiljare të divorcuar/të veja me fëmijë në ngarkim.
  
- 2. Të miratojë procedurat mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind, si më poshtë:**
  - Njësitë Administrative përpunojnë listën e përfituesve të mundshëm dhe vlerësojnë dosjet për t’u trajtuar me këto fonde.
  - Njësitë Administrative dërgojnë çdo muaj pranë Sektorit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror listën e përfituesve të mundshëm për të përfituar nga ky fond.
  - Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror harton projektvendimin për familjet në nevojë, në bazë të propozimeve të ardhura nga Njësitë Administrative, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6 për qind.

**3. Të miratojë dokumentacionin që duhet të plotësojë Administratori Social mbi aplikimin e përfitimit nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind, si më poshtë:**

- Kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtareve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti.
- Çertifikanën familjare që lidhet me regjistrin e familjes për të gjithë ata persona që janë pjesë e të njëjtës gjendje familjare.
- Dokumenta të tjera të nevojshme, për të përcaktuar të ardhurat familjare.
- Urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjehershëm të mbrojtjes, për rastet e parashikuara.
- Vërtetimin e gjykatës që bashkëshortët e familjes që paraqitet për të përfituar ndihmën ekonomike janë në proces zgjidhje martesore.
- Kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar.
- Kopjen e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësive për Punë, për familjet që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuar që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, përfshirë edhe dokumentacionet e tjera.
- Certifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës (tapinë e tokës), për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende.
- Vlerësimin social-ekonomik për çdo aplikues.
- Kartelën e papunësisë të firmosur çdo muaj nga zyrat e punësimit për antarët madhorë, (nëse familja nuk ka përfituar tokë bujqësore, të cilët jetojnë në fshat dhe nëse familja jeton në qytet pavarësisht trajtimit ose jo me tokë bujqësore).
- Dokumentacioni shkresor nga Njësitë Administrative përmban:
  - Listën përmbledhëse emërore e përfituesve të mundshëm
  - Tabela përmbledhëse mbi numrin e familjeve dhe fondin e parashikuar

4. Familjet e përzgjedhura do të përfitojnë ndihmën ekonomike nga fondi i kushtëzuar i programit të bllok-ndihmës deri në 6 për qind
5. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Korçë.

Konceptoi: (Emër Mbiemër)  
Përgj. Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror: A. Lenja  
E. Petriti

Nënshkrimi

Data  
Dt 22.01.2024  
Dt 22.01.2024

**KRYETARI BASHKISË**  
**Gëzim Topçiu**